



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE “XHAFERR KONGOLI” ELBASAN

Data 19.06.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirembajtje e Impianistikes Spitalore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50000000-5 Sherbime mirembajtje dhe riparimi

VLERA E FONDIT LIMIT/ Vlera e pritshme e kontrates: Fondi limit-2,520,650 (dy milion e peseqind e njezet mije e gjashtëqind e pesedhjetë) leke pa Tvsh Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) *Formulari i ofertes ekonomike, sipas shtojces 1.*
- b) *Formulari i sigurimit te ofertes, sipas shtojces 3.*
- c) *Formulari permbledhes i vetedeklarimit, sipas shtojces 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

-Operatori ekonomik duhet të jete I pajisur me license profesionale të shoqërisë e vlefshme me kategorine:

NS-12/A – Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

NS-14(A) – Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” : “4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar me lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në *nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhezimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij ,(Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB).(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar. Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit

Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se: “*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: ... Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*”. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

-Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 13 punonjes të siguruar nga të cilet:

-1(nje) Inxhinier Mekanik (Drejtues Teknik të identifikuar në Licensën e kompanisë), për të cilin operatori duhet të paraqesë:

a)Diplomen

b)CV-ne

c)Kontraten Individuale të punës

d)Certifikate për Auditimin e Energjisë: Certifikimi duhet të jetë i leshuar nga një institucion i akredituar në Shqipëri.

-1(nje) Inxhinier elektrik për të cilin operatori ekonomik të paraqesë diplomën, CV-ne dhe kontratën individuale të punës.

Te këto stafin e punonjësve të pasqyruar në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.Për punonjësit e mëposhtëm operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikate sigurimi teknik ose dëshmi të kualifikimit.

-2 punonjes elektrikist

-1 punonjes saldator

-4 punonjes specialist kondicionimi”instalues paisjes kondicionimi”

Në zbatim të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010” Për sigurinë dhe shëndetin në punë”Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një punonjes, pjesë e stafit që të jetë i pajisur me certificate trajnimi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Për këto të paraqitet certifikata e trajnimit. Spitali nuk mban përgjegjësi për asnjë aksident të shkaktuar nga operatori gjatë punës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 4 c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Aftësia e operatorit ekonomik varet nga aftësia e punonjësve që do të caktojë për zbatimin e kësaj kontrate. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin

publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

-Operatori ekonomik ofertues duhet te deshmoje se ka ne pronesi ose me qira mjetet dhe pajisjet e meposhtme:

Automjete ATP	- 2(dy) Cope
Gur fleksibel	-1(nje)Cope
Trapan	-1(nje)Cope
Saldatrice	-1(nje)Cope
Shkalle metalike e levizshme	-1(nje)Cope

-Ne rast se mjeti eshte ne pronesi OE duhet te paraqese –Certifikate pronesie, leje qarkullimi,siguracion,akt kolaudim,taksa vjetore.

-Ne rast se mjetet jane me qera operatori ekonomik duhet te paraqese kontrate qeraje noteriale, certifikate pronesie te qiradhenesi, leje qarkullimi,siguracion,akt kolaudimi,taksa vjetore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

-Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me certifikatat e meposhte (te vlefshme) objekti i te cilave te jete ne perputhje me objektin e prokurimit:

- Certifikate ISO 9001:2015 te vlefshme ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise.(Certifikata duhet te jete e leshuar nga organismat e vleresimit te konformitetit,te cilet jane te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA)ose nga organizma kombetare akreditues
- Certifikate ISO 14001-2015 te vlefshme ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te mjedisit Certifikata duhet te jete e leshuar nga organismat e vleresimit te konformitetit,te cilet jane te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA)ose nga organizma kombetare akreditues
- Certifikate ISO 50001-2011 te vlefshme ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te energjise e cila te perfshije objektin e prokurimit. Certifikata duhet te jete

- e leshuar nga organismat e vleresimit te konformitetit, te cilet jane te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma kombetare akreditues
- Certificate ISO 3834-2:2006 te vlefshme ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldime te materialeve metalike. Certificate duhet te jete e leshuar nga organismat e vleresimit te konformitetit, te cilet jane te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma kombetare akreditues
 - **Argumentimi:** Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", nenin 44, pika 3,4 te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"
 - Me ane te ketij kriteri kerkohe qe operatoret ekonomike te deshmojne se zoterojne Certificatekat perkatese qe i mundeson Autoritetit Kontraktor per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertes eshte ne gjendje te realizoje sherbimin ne menyre cilësore qe parashikohen nga legjislacioni ne fuqi per kryerjen e sherbimeve, ne perputhje dhe ne lidhje te drejtperdrejte me objektin e kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, date 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

1. Materialet qe do te perdoren per zevendesim te jene te reja ne perputhje me standartet e komunitetit europian (CE).
2. Impianistika perfshin mirembajtje te kapitujve te preventivit

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mirembajtje e impiantistikes qe do te njoftohet nga autoriteti kontraktor operatori ekonomik duhet te paraqitet brenda 2 oreve dhe te pergjigjet me kryerjen e sherbimit brenda 12 oreve.

Nr	Emërtimi i punimit	Njësia	Sasia	Vendi I Ekzekutimit	Afati I Ekzekutimit
I	SHERBIM DHE MIREMBAJTJE SISTEME AJRI I KONDICIONUAR				
1	Shërbim teknike dhe riparim në pompë nxehtesie Ajer - Uje me kapacitet termik ne ngrohje 137.5 kw. E kompletuar me grupin hidrik me kapacitet 320 litra, me komndim ne distance si dhe elemente te tjere te kontrollit te Gazi R410 A	O.pune	48	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
2	Shërbim teknike dhe riparim në pompë nxehtesie Ajer - Uje me kapacitet termik ne ngrohje 42 kW. E kompletuar me grupin hidrik me kapacitet 190 litra, me komndim ne distance si dhe elemente te tjere te kontrollit te Gazi R410A	O.pune	48	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
3	Riparim,programim I paketes elektronike te komandimit te chillerit nga salla	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
4	F.v. rripa transmisioni per ventilatoret	cope	4	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
5	Mbushje me gaz R 410 C	litra	18	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

6	F.v. bateri gjeneratori elektrik 110A 12V	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
7	F.v. filtra ajri bakterilogjik 99.99%. Dim.610 x 610 x 150 mm, kornize metalike tek sallat e operacionit dhe pastrim filtrave ekzistues	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
8	F.v. parafiltra tek AHU	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
9	Sh. Teknik dhe riparime mirëmbajtëse në Fan - Coil/kaloriferë	O.pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
10	F.v.armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1" x 32 mm, per termoizolimin e tubove ne tarrace, te veshura me flete alumin (jashte)	ml	16	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
11	F.v. armaflex per tubo bakri nga Ø 6.35-22,5 mm	ml	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
12	Sh.teknike e riparime në pompe qarkulluese Q=5-6m³/h dhe H=4 m	O.pune	8	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

13	Sh.teknike në panelet e komandimit elektrik-elektronik për të gjitha instalimet mekanike	O.pune	28	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
14	Kontrolli dhe mirëmbajtje e tokëzimit të motorëve elektrik, kontrolli dhe mirëmbajtja e paisjeve elektrike të punës dhe të mbrojtjes	O.pune	20	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
15	Sherbim, kontroll dhe riparim I sistemit te ndezjes (motorrini,dinamo, paketa elektrike) gjeneratorit elektrik 250 kw dhe gjeneratorit elektrik 30kw	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
16	Riparim, saldim me gas dhe kontroll me azot i serpentinave dhe tubove te gazit te chillerit	komple t	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
17	F.v. valvul sigurie 3/4 ne vakum	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
18	F.v. valvul moskthimi DN50	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
19	F.v. nxjerrës ajri (çajruesa) rrjeti	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

20	F.v. maometër uji 10 bar	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
21	Sherbim, nderrim filtra, vaj gjeneratorit 250 kW	komple t	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
22	Sh teknike dhe kontroll I Valvoles elektronike VRF per hapje fan coil No9901866,Ps 4 Mpa,380-415V, 40A dhe mbushje me gaz R 410C I linjes fan coil	O.pune	20	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
23	Shërbim teknike No9901866, Ps 4 Mpa, 380-415V, 40A Mbushje me gaz R 410 C I linjes fan coil	O.pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
24	Riparim pakete eletronike VRF No9901866	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
25	Sherbim, pastrim fryresave (filtrave) te ajrit dhe pulteve (42 cope) te komandimit te fan coil ne godinat e urgjences dhe pediatrie	O.pune	96	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
26	Sensor presion gazi R410 No9901866, Ps 4 Mpa, 380-415V, 40A	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

27	Sensor temperature Facoil No9901866, Ps 4 Mpa, 380-415V, 40A	cope	10	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
28	Sensor temperature te gazit Facoil No9901866, Ps 4 Mpa, 380-415V, 40A	cope	10	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
29	Riparim i ventilatoreve te ftohjes se cillerit (kushinet,aks motorri, grupi diodave dhe elemeteve)	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
30	Riparim, avalzhim I motorrit te AHU (njesise te trajtimit te ujit)	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
31	Çmontim, riparim, montim I motorrit te kompresorit te cillerit 137,5 kw	O.pune	16	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
	Çmimi neto I			Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
				Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

II	SHERBIM DHE MIREMBAJTJE E POMPAVE TE UJIT DHE SISTEMIT TE NGROHJES			Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
1	Sh.teknike e riparime në grupi i furnizimit me uje, pastrim depozite uji, presostati, ballon ajrimi	O.pune	48	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
2	Riparim I panelit elektronik te komandimit te pompave ne godinat(kirurgji, urgjence, pediatri)	Cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
3	F.v. galixhant depozites te pompes ujit 3,2kw	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
4	F.v. Kit elektronik pompe uji	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
5	F.v. kushineta db=25-35	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
6	F.v. permistope te pompave	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

7	Riparim,avalzhim motorri, pompe uji Grundfos 3,2kw	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
8	F.v. manometer presioni 6 bar	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
9	Riparim (saldim, xhuntim) tubo uji sist ngrohjes Ø50	O.pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
10	Riparim, pastrim,zev. ventilash te grup-elementeve ngrohjes (kalorifereve)	O.pune	48	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
11	Riparim sherbim kaldaje pelleti pavioni urgjences re (djegesi, vatra zjarrit, paketa e komandimit, shneku)	O.pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
12	Riparim pastrim saraciceska DN100 sist ngrohjes	O.pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
13	F.V Grup rimbushes automatik	cope	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

	Çmimi neto II			Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
				Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
III	SISTEMET E FURNIZIMIT ME GAZRA MJEKËSORE: AJËR I VAKUMUAR DHE I KOMPRIMUAR, OKSIGJEN DHE PROTOKSID AZOTI			Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
1	Shërbime teknike ne kompresor ajri mjekesor	Orë pune	48	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
2	Shërbime teknike në pompa vakumi mjekësore	Orë pune	48	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
3	Shërbime teknike në panele, linja dhe vakumetra deri të shtrati i pacientit	Orë pune	32	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
4	Sh. teknike në panele automatike, linja dhe paisje komprimimi deri te shtrati i pacientit	Orë pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

5	F.v. vaj, filtra per 9 kompresoret e ajrit dhe 2 pompat e vakumit(kirurgji,urgjence, pediatri)	litra	33	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
6	F.v grup kompresori ajri model KA4 4KW 10BAR	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
7	F.v. filter ajri koleshente F 005S	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
8	F.v. filter ajri me qeramike F 005P	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
9	F.v. insto ajri komprimuar	copë	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
10	F.v. insto ajri vakumuar	copë	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
11	F.v.priza ajri	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

12	F.v. xhunto plastike	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
13	F.v. llampa sinjalizimi	copë	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
14	F.v. portollampa	copë	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
15	F.v. butona lëshimi	copë	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
16	F.v. lëshues me rele termike	copë	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
17	F.v. elika të motorëve central vakumi	copë	2	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
18	Tarim manometri	Orë pune	8	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

19	Kontroll teknik i valvolave të sigurimit te pompave te vakumit dhe kompresoreve te ajrit	Orë pune	16	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
20	Kontrolli dhe shërbim i rampave të gatishmërisë, linjave dhe reduktoreve të O ₂ dhe N ₂ O	Orë pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
21	F.V Rampe me tre poste e mbushjes se bombolave O2 te autoambulancave me presion deri 110bar me aksesoret (tubo bakri me presion deri 300bar,manometer presioni deri 300bar, tub fleksibel I presionit te larte deri 300bar, ventila,Ti, rakorde presioni deri 250 bar)	komplet	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
22	Kontroll teknik i valvoles të sigurimit , manometrave te presionit, kalimatesi i sasise se lengut O2 ne enen kriogjenike te tankerit te O2 lengshen dhe nyjet lidhese.	Orë pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
23	Shërbime teknike,programime të panelevelele elektronike te sinjalizimit te alarmit per rrjedhje gazrash mjekesore dhe sensoret e alarmit te mbrojtjes nga zjarri	Orë pune	24	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
24	F.v pakete centraline kompresori ajri model KA4 4Kw 10bar C 053 m3/min	cope	1	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj
25	F.v serperator ajri kompresori ajri model KA4 4Kw 10bar C 053m3/min	cope	4	Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan	12 Muaj

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi te njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas shkresës për këtë procedure prokurimi në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.